



KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-09/2026

Më datën 21.08.2026

Bazuar në nenin 43, paragrafi 1, të Ligjit, Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28”, e në mbështetje të nenit 5, të udhëzimit administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenin 33 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë;

Për datën 31.08.2026

Ora 10⁰⁰

C A K T O N

Mbledhjen e 9, (nëntë) të rregullt për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës në Suharekë, dhe njëherit propozoi këtë:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtora të shkollave;
4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-016-28760 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për “Zonën Ekonomike në Duhël”;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen qytetarë nderi;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Suharekës;
9. Pyetje përgjigjeje;

Mbledhja mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Suharekë te shtëpia e kulturës “Ukë BYTYÇI”.

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI